

DOKUDAILY

NUMRI I DHJETË

EDICIONI XXIV

E DIEL, 10 GUSHT 2025



SHIHEMI VITIN TJETËR!

FOTO: GRESA NUREDINI

PËR KULTURËN. PËR DOKUFESTIN.

Në DokuFest kam njohur miq që do t'i kem përjetë, kam njohur një tjetër blu të qiellit në agim, që nuk barabitet, me asnjë grimë nuance të asnjë qielli tjetër në botë. Por mbi të gjitha kam njohur në hapësirë të jashtëzakonshme që merret me prodhim dhe artikulum të kulturës filmike si në asnjë hapësirë në Shqipëri dhe Kosovë.

Di rrëfimet që para viteve '50 në këtë qytet janë shfaqur filma nëpër kafehane. Në vitin 1952, u hap kinemaja e parë në Kosovë, e ajo është Kino Lumbardhi (Bistrica), vend ku shumë prej nesh ndiejmë se na prehet shpirti, e këtë vit e kam njohur këtë mungesë të asaj hapësire (për shkak se ndodhet në proces renovimi) deri në thelat e ndjeshmërive të mia. Lidhja me hapësirat është dicka më e fortë se dikush mundet ta mendojë. Syri lëviz me të njëjtin automatizëm sikur në shtëpinë ku ka jetuar për vite me radhë. E këtë vit, kjo shtëpi, e këto kinema u shtrinë edhe në hapësira të tjera të qytetit. Por DokuFest, ka qenë katalizatori që kinematë në këtë qytet të ekzistojnë e të frymojnë. Ndoshta nuk duhet thënë në formë kaq poetike.

Ky organizim është arsyeja përse kinematë në këtë qytet e kanë gjetur një rrugë të vetën, ku ne takohemi me njerëzit që përzgjedhin filmat, që punojnë në logjistikë, që rrinë me dedikim të madh në dhomën e projeksonit, të njihemi me njerëz që hapin dhe mbyllin dritat kur filmat shfaqen, që na mikpresin në sallën e kinemasë, apo të njihemi edhe me ata që nuk duan të pushojnë së foluri kur filmi është duke u shfaqur.

Në DokuFest po ashtu e kam njohur një hapësirë mendore mes të cilës, mundem të bëj dicka për të cilën do përpiqem tërë jetën ta bëjë të ndodhë e të ecë në ritme normale. Të shkruarit për kulturë. Të reflektuarit, analizuarit, kundruarit dhe mundësisht, me gjasë të gjejmë një sy që lexon në heshtje ato mendime të përmbledhura në shkrime. E kjo hapësirë ndërtohet me durim dhe përkushtim. Dhe është e vështirë. Por ndodh. Prej vitesh të tëra DokuDaily ka qenë ndër platformat e vetma që ka patur fokus të përveçëm në të shkruarit për filma dhe gjithë botën që sjell me vete.

Të shkruarit në shqip, për kulturë, është po ashtu një nga çështjet më eminente dhe urgjente, ku liria e fjalës gjen pengesa të jashtëzakonshme në absurdin e të jetuarit në një botë që vec për informacion nuk vuan.

Vec për këtë hapësirë të krijuar, unë ftoj këdo që e lexon këtë shkrim, duke shtrirë një ftesë të madhe e të gjërë për këdo që ka pasion shkrimit dhe analizën e mirë, të bëjë një përpjekje e të mos dorëzohet. Një hapësirë e tillë është dhe ekziston në Prizren e DokuFest. Në këtë qytet që mbërrin të kthejë cdo hapësirë në një kinema. Për ju të gjithë që lexoni dhe shkruani, këto hapësira duhet t'i mbajmë së bashku. Qoftë sikur edhe një herë në vit.

Le ta shkruajmë e lexojmë kulturën, në format tona, me gjuhën tonë. Është detyrë e jona.

Shkruar nga Blerina Kanxha



DISA PREJ JUSH U PYETËN GJATË FESTIVALIT SE ÇFARË DO TË THONË PËR JU "PAFUNDËSI", "LAKMI", "ÇMENDI" DHE "BOSHLLËK". KËTO JANË DISA NGA PËRGJIGJET:

PAFUNDËSIA ËSHTË PUNË. PUNË NJERËZORE. DHIMBJE. FAMILJE. SHTËPI. DASHURI. GJENOCID. NJERËZIM. KINEMA. SHPRESË. HORIZONT.

LAKMIA ËSHTË PRECIZE. NJË SISTEM KU JETOJMË. E SHËMTUAR. NJË MËKAT. JO SPECIFIKE. DURIM. GJITHÇKA QË NUK ËSHTË DASHURI. FUQI. NUK E DI. MASIVITET. PRONËSI. PABARAZI. PËRTACI. MILIARDERËT.

ÇMENDIA ËSHTË STABILITET. NUK KAM PËRGJIGJE PËR KËTË. VAPAI. GJITHÇKA QË E TEJKALON TË TASHMEN. FAMILJA. E GJITHË BOTA. GJENDJA IME AKTUALE. PRIZRENI.

BOSHLLËK ËSHTË NJË VRIMË E ZEZË. E KUNDËRTA E PAFUNDËSISË. PAMUNDËSI. MUNGESË E EMPATISË. ILUZION. PANDJESHMËRI. MADHËSI. FRIKË.

INTERVISTË

Katastrofikisht e përkryer

Flasim me Alba Çakallin, producenten e festivalit, ditën e fundit para Ceremonisë së Mbylljes së DokuFest



ENDLESS GREED MENTAL VOID

PHOTO: ELMEDINA ARAPI

Në fillim të festivalit, folëm me Albën, në një moment që u duk se gjithcka po shpërthente vec disa momente para festivalit, por që pas cdo të keqeje vjen një e mirë. Dhe Alba me ritmin e saj gati luftarak dhe të drejtpërdrejtë në të folur, na jep një renditje të të gjitha zallamahive që sillen në prapaskenat e festivalit. Kjo për të kuptuar që organizime të tilla, megjithëse na sjellin në shpirt gjithë poezinë dhe bukurinë e jetës dhe mendjeve krijuese, kërkon edhe kocka të forta që ta mbajnë më këmbë.

Ditë për ditë, njëherë ishte calm before the storm : “ja kena nis me gëzim sa ka nis festivali”. “Target ka qenë me ul shpenzimet, me shtu fitimet, e mendoj që e kemi gjetur një mënyrë këtë vit, packa se ende nuk kemi parë balancet pasi ajo është punë e javës tjetër.” - tha Alba.

“Ekipi i ka dhon zor shumë seneve dhe kena përmirësu infrastrukturën digjitale të festivalit që është një sen shumë i mirë”; “Plus kjo fatkeqësia e buxhetit që na u ka ul dhe janë rritur cmimet, mendoj që ja kemi dal ta menaxhojmë”; “Kinematë kanë qenë plot” - këto Alba i tha gati me një frymë. Por e gjithë kjo nuk bëhet vetëm, e ajo shprehet: “Sot po e mendoja, pa ekipin, pa suportin e njerëzve, ky sen nuk bohet, e unë nuk jam njeri që kam qejf të jap urdhra, por ja që ka ndodh edhe ky sen, por në fund të ditës, bashkëpunimi me njerëzit ka qenë shumë i mirë.”

Vijojmë me

“Lejen e makinës ma kanë marrë një ditë para festivalit.” Ne këtë e dimë pasi ndodhi në një moment para provave në kala. Por cka ndodhi më pas është kjo pengesë packa dëshirës së saj për ta vuajtur dënimin në formën e plotë, mes takimeve të ndryshme me miq, Alba pa sërish policin që ia mori lejen, e duke gjetur një formë për ta ankimuar, por duke ndjekur ritmin e festivalit, edhe koha për ankesë pat kaluar.

Përsa i përket produksionit, Alba na flet për ambiciet e mëdha që lidhen me realizimin e koncerteve, pos punës së përditshme në kinema, dhe më pas flet me institucione të ndryshme të të gjitha niveleve e me gjithë infrastrukturën, pasi nuk është puna vetëm me stafin e festivalit, me policinë e gjykatat, dhe në fund flet me dikë që mund të jetë i vetmi në Prizren që ka njohurinë të merret me agregatët dhe na jena detyru të bëhemi edhe inxhinirë edhe mekanikë edhe elektrikistë. Dhe kupton që mund të bësh gjithcka, por fati i një festivali mund edhe të mbetet në dorën e vetëm një ustai.

“Natën e performancës së Ylli Limanit, më thërrasin e më thonë që agregati i tretë s’po ndizet.” Alba mandej ka nisur në formën e saj ta mobilizojë një Prizren të tërë, që të mos kishte ngecje teknike. Asnjë piskamë nuk është lëshu në asnjë moment. Mandej po atë natë, duke patur prezencën fizike të sigurt të ustait, ndërsa të gjithë po kujdeseshin që gjithcka të shkonte në rregull me audiencën.

Në këtë edicion pas perdes së zezë përfshihen edhe kërkesa për ftesa, institucione, dhe e vetmja gjë që mund të themi për këtë moment, sidomos për çështje të pranisë nëpër koncerte mund të themi vetëm: Pse nuk e keni blerë në kohë biletën?

“Po mandej u bo mirë” - tha Alba.

Alba parashikoi edhe skenarët më të mundshëm mbi problematikën që mund të ndodhnin në performancën e fundit, por gjithcka shkoi në një sintoni të jashtëzakonshme. Ndaj duhet të gëzohemi për këtë gjë.

Duhet shumë njerëz për të bërë një festival, por na duhen edhe njerëz si Alba që të na shtojnë para. Shihemi në rrëfime të këtilla, edhe në vitet e ardhshme!

Kur na mikpresin më të mirat!

Bisedë me Ardora Çakallin dhe Erëza Kirajtanin



Prizreni është qytet mikpritës, por mikpritja është lëmi e vështirë dhe e ndërlikuar. Sidomos kur kupton qe rehatia e shtëpisë, nuk mund të zëvendësohet me asgjë. Shpesh në këto numra të Doku-Daily kur kemi biseduar me njerëz të ndryshëm, e kanë shpallur ndjesinë e familjaritetit në qytet si diçka që është lehtësisht e vërejtshme dhe e përbrendësueshme. Dhe vërtetë, në mënyrë që organizimet kulturore sado të vogla qofshin ato e kërkojnë me vete një ekip të zellshëm, të palodhur që mund të funksionojë me perfeksionin e makinerive, por natyrisht të dijë të thotë fjalën e mirë. Diçka brenda kufijve të perfektes, pak a shumë.

Ardora dhe Erëza, të dyja punojnë prej vitesh në DokuFest. Edhe njëherë, është çështje familjare për to, por jo aq ëmbël dhe privilegie sa dikush mund të mendojë pasi shpesh bëhen shembull pa dashje për kolegë të tjerë. Për Erëzën është hera e parë që punon në departamentin e mikpritjes, pasi ka kaluar nga të qenurit vullnetare, në departamentin e medias e më së fundi rikthehet në këtë departament duke siguruar që secili prej të ftuarve të ketë rehatinë që dëshiron gjatë festivalit. Ardora ka kaluar nëpër këto eksperiencë edhe vitet e kaluara. Prej të ftuarve që për fat të keq vijnë në Prizren me probleme shëndetësore, tek telefonatat e orëve të vona sepse dikush ka humbur celësin, apo te dëshirat të tipit: ku mundemi me gjet vend për me bo thonjt’?

Në rrethana të tjera vajzat do të duhet të ishin shfryrë se dikush ka harruar të bëjë check-in-in, apo se taksisti ka ngatërruar aeroport për të marrë të ftuarit. Largësia midis aeroporteve të Shkupit, Prishtinës dhe Tiranës, është e konsiderueshme. Por, Erëza na thotë se këtë vit sistemi i komunikimit në departament është automatizuar në mënyrë të mjaftueshme për të shmangur telefonata të panevojshme. Por a ka telefonata të panevojshme? Ato kurrë s’kanë për të rreshtur.

Ne si DokuDaily e dimë rëndësinë e gjumit të mirë, ndaj i pyetëm Erëzën dhe Ardorën se si është dita e tyre. E Ardora thotë: “Ne për shkak që jemi “hospitality”, merremi me shumë njerëz, e po vijnë prej krejt botës dhe për secilin sen na lypin me ndërru dhomën apo hotelin, por duhet ta mirëkuptojnë që nuk është gjithmonë mundësia, e nuk mundet gjithcka të bëhet në moment. Erëza flet për faktin se zakonisht njerëzit janë detajistë, ndaj nga kurioziteti synojnë të dinë gjithcka.

Ardora flet për vitin e kaluar, ku ka patur raste çështjet e emergjencës kanë lëvizur nga boshti i “kam thyer dhëmbin më co tek dentisti” e deri tek “ku mundem me i ndreq flokët, më co te frizerka”. Por këtë vit, historitë më frekvente nuk kanë qenë emergjente, por vapa e Prizrenit ka alivanosur shumëkënd dhe thirrja e ambulancës ishte e udhës. Por Ardora thotë: “ne si hospitality nuk lëmë askënd keq, e krejt rastet ua kemi plotësuar dëshirat.”

Shpesh transporti dhe komunikacioni bëhen tema të nervozizmit, pasi shpesh dëgjoen tema të tilla si: “unë nuk pyes departamentin, unë shkoj të dua unë”, “nuk cohem unë në orën pesë, unë cohem kur të dua vetë”. Po si Ardora dhe Erëza janë mësuar me këto fjali ndaj me shumë butësi, por edhe me një sens të fortë të emergjencës arrijë të rehatojnë këdo.

Në momentin që flasim me to dikush që sapo ka ardhur në Prizren dhe u kërkon në mënyrë të menjëhershme që të ketë një vend qëndrimi në Prizren. Në një Prizren ku hotelet janë plot, fluksi i vizitorëve të festivalit, por edhe i diasporës është në kapacitet maksimal, por sërish gjendet udha, diku në këtë qytet gjendet një shtëpi, një vend ku mundesh me vënë kokën në jastëk. Këto kërkesa të menjëhershme janë normale për vajzat. Janë mësuar tanimë.

Këtë vit puna me transportin ka qenë më e qetë, falë bashkëpunimit me GoOpt, puna me shtëpitë mikpritëse ka qenë me e reduktuar, por sërish nuk kanë munguar rastet kur ndonjë vizitor nuk ka kuptuar se prej cilit aeroport duhet të niset duke e tjerë edhe konceptin e vetë kohës. Por vajzat kanë durim olimpik.

Sepse Prizreni di të mikpresë, e di të mikpresë më mirë se cdo vend tjetër. Atyre u vjen mirë që njerëzit kanë interes shumë për festivalin dhe se e dinë eksperiencën e të qenurit vizitorë diku tjetër. “S’bon për cdo sen me u anku” - thotë Ardora. Por ka dhe surpriza të bukura, kur shumë e shumë vizitorë mbeten të mahnitur me mikpritjen saqë e gjejnë një moment për të bërë dhurata e për t’jua shprehur falendermin në mënyrën e tyre. “Ndonjëherë na kanë dhon edhe pare, e ne i kemi nda krejt ato pare e kena shku në kafe.”

Të punuarit në DokuFest për to është edhe një traditë tanimë pasi kanë anëtarë të tjerë të familjes që po ashtu punojnë në festival, e Ardora na thotë që: “ndonjë nuk është dhe aq mirë. Erëza na thotë: “na na duhet me qenë shumë herë ma të vëmendshëm, për gjithcka.” Momentet e pushimit për to në festival janë koncepti i një tjetër universi. Por këtë punë e bëjnë me dashurinë më të madhe.

Këtë vit departamenti i mikpritjes i ka pritë më shumë se 250 vizitorë, e duhet kuptuar që puna e tyre, e kujtudo që punon në mikpritje është krejt e pacmueshme. Vajzat janë gjithmonë me buzëqeshje në fytyrë dhe me merak në sy që gjithcka të shkojë mirë. Ne folëm së bashku ditën e fundit të festivalit në edicionin e vetë të 24-t, e u ndihej clirimi në sy se sic thonë: “tash krejt kanë shku”, por si Ardora si Erëza janë shembuj të një rinie që nuk lodhet së punuari dhe e bëjnë këtë festival, ai që ne e dimë se është e që e duam pafund.

DOKUNIGHTS

Instalacioni “ResistanceExistence” ndrinte prej ngjyrave që vërviteshin sa prej skenës e deri në kodër. Hëna e plotë sapo ngrinte kryet mbi kala e audienca që vinte prej Marashit e ndiente këndelljen në ajër të muzikës që vjen drejt nga shpirti i butë e që do jetën në atë lëmshin e urtë të Shqipërisë së Mesme. Orkestra Berati në skenën e Kino Lumit.

DokuNights ka bërë gjithmonë vend për muzikën më të mirë shqiptare duke sjellë grupin Saz’iso, River Voices apo Orkestra Shkodra vitin e kaluar. E kësaj radhe kërcyem e festuam me ritmet lozonjare të muzikës tradicionale popullore të Beratit. Ky formacion muzikor nën kujdesin e Oda3 ka zhvilluar një album që e mbledh gjithë eksperiencën e gëzimit dhe ledhatimit të jetës nëpër tinguj, në një muzikë që flet me gjuhën e brendshme të qytetit të Beratit. Muzikantët e mirënjohur si Mehmet Topi, Albi Kadëna, Florenc Qafa, Altin Nuka, Adrian Hodaj, Lutfi Keci dhe Arjanit qafa bashkohen me zërat absolutisht të papërsëritshëm të Petrit Berishës dhe Ludmilla Baballëkut, e ne patëm fatin që ta hidhnim në valle nën muzikën e tyre.

Njerëz kudo, në sheshpushimin pranë lumit, ku gati tinëzisht e me hapa të shpejtë njerëz të ndryshëm zbritën për ta parë skenën prej poshtë. Nëpër muret rreth skenës njerëz të ulur e më këmbë po dëgjonin me endje. Në skenë, në reflektimin e gjithë dritave të Prizrenit rrokulliseshin lëvizjet elegante të duarve, flokët që i merrte era në këngë që bëjnë bashkë Prizren e Berat.

Pulsi i Beratit dhe pulsi i Prizrenit

Për këdo që i ka dëgjuar këto këngë që në fëmijëri, janë motive të një jete që segmentohet në cdo rast gëzimi familjar, apo në festat e fundvitit. Janë tekste të cilat artikulojnë vetvetiu dhe e rrëfejnë jetën dhe dashurinë në format më të thjeshta e më të thella. Për shumë, të dëgjuarit e këtyre këngëve, mund të sjellë idenë e festës dhe nostalgjisë dhe e hedhjes së krahëve në ajër për të harruar të gjitha problemet. Qoftë duke rrëkëllitur rakinë e përatyshme, e qoftë duke u shtruar me sytë tek lidhen me qielin mes një fije në gjilpërë.

Nata e fundit e DokuNights, na solli të gjithëve bashkë, me një emocion që edhe vetë gjuha mund të shkojë në hapësira të paartikulueshmes. Duke tundur shamitë, duke menduar për vashat me namuz në dritare, duke menduar për djemtë që ecin nëpër rrugët e kalldrëmta, duke fshehur emocionin në bisht të syrit, këngët e Beratit, na lidhën me atë që ne e duam më së shumti në traditën tonë. Të paturit e ndjenjës së përkatësisë me dy këmbë në tokë, vec në tinguj që tirren në ajër.



FOTO:LUKA STRIKA

CEREMONIA E MBYLLJES

okuFest përmbylli edicionin e 24-t, në skenën e Kino Lumit, aty edhe ku u hap këtë vit ky festival, aty dhe jemi mbledhur për nëntë ditë me radhë për të parë filma së bashku. Ceremonia e Mbylljes nisi me një video që përvijonte kumtin e hapjes së këtij viti të DokuFest, duke vënë theksin mbi gjendjen e okupimit në Gaza, në popujt e shtypur dhe në mënyrën se si ne e artikulojmë apo qëndrojmë ndaj këtyre realitete.

Për nëntë ditë, festivali prezantoi 213 filma, mirëpriti 9 performanca, 8 diskutime, 4 masterklasa dhe 6 punëtori në 9 kinema dhe hapësira të improvizuara nëpër qytet, përfshirë edhe ambientet e ITP-së.

Ky edicion i suksesshëm në Dokufest e pati kulmin duke na njoftuar me atë cka më së shumti na ka kuriozuar gjatë festivalit: fituesit!




Çmimi I Distribuimit: Ndera – Endrit Qarolli
në bashkëpunim me Radiator IP Sales




Çmimi I Audiencës: Palace of Youth – Maddie Gwinn
(mundësuar nga ProCredit Bank)



Çmimi I Docyouth Alliance: Coexistence, my Ass! – Amber Fares



Çmimi Per Filmin Më Të Mirë Të Shkurtër Ballkanik: Merging Bodies – Adrian Paci



Çmimi Per Filmin Më Të Mirë Të Shkurtër Ballkanik: Antigona – Iber Dëari & Mirsad Abazi

Mirënjohje e veçantë



Çmimi I Filmit Më Të Mirë Ballkanik: Soil and Wings – Stefan Malešević

mundësuar nga IPKO



Çmimi I Filmit Më Të Mirë Ballkanik: A Strange Colour of Dream – Yasemin Akinci

Mirënjohje e veçantë



Green Dox: May the Soil Be Everywhere – Yehui Zhao

Mirënjohje e veçantë



Çmimi Për Kategorinë Green Dox: Shifting Baselines – Julien Elie




Çmimi Për Kategorinë Human Rights Dox: My Dear Théo – Alisa Kovalenko




European Short Film Award: Masterpiece Mommy – Dorothy Sing Zhang




Çmimi Për Filmin Më Të Mirë Të Shkurtër Ndërkombëtar: Blue Heart
– Samuel Suffren



Çmimi Për Filmin Më Të Mirë Të Shkurtër Dokumentar: We Were the Scenery –
Christopher Radcliff



Çmimi Për Filmin Më Të Mirë Të Gjatë Dokumentar: Action Item – Paula Āurinová
ne bashkepunim me Ambasaden Suedeze dhe SIDA



Çmimi Për Filmin Më Të Mirë Në Kategorinë Kombëtare: SOS – Anita Morina

Për të lexuar motivacionet e jurive, ju ftojmë drejtoheni [këtu](#).





Fotografët:
Elmedina Arapi
Ferdî Limani
Suer Celina
Sara Çafleshi
Gresa Nuredini
Luka Strika

Ekipi i DokuDaily:
Fisnik Minci
Blerina Kanxha
Gus Edgar-Chan
Scott Hoy
Shefket Bujari
Denan Miftari
Alajdin Abishko
Lendina Balaj
Carson Baley

General Sponsor 	Principal Partner 	Principal Partner 	Golden Sponsor 
		 	
			
			
  		